

VENDIM
Nr.229, datë 23.3.2011

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.504, DATË 13.5.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË ISH-
SPITALIT TË KFOR-IT, DURRËS, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA
E SHËNDETËSISË, PËR TRAJTIMIN E PERSONAVE ME MASË MJEKËSORE
“MJEKIM I DETYRUAR NË NJË INSTITUT MJEKËSOR””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.504, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të ish-Spitalit të KFOR-it, Durrës, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Shëndetësisë, për trajtimin e personave me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor””.

2. Ish-Spitali i KFOR-it, Durrës, kalon në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha